

MUHARREM GASHI

VEÇORI TË ORIENTALIZMAVE NË TË FOLMEN
E PRIZRENIT ME RRETHINË

Abstrakt

Nga fjalët e huaja, në gjuhën shqipe kemi edhe një numër mjaft të madh me burim oriental. Prania e këtyre fjalëve në të folmen e Prizrenit dhe rrethinës së tij, ashtu si edhe në meset e tjera ka përfshirë pothuajse të gjitha sferat e sidomos atë të jetës shoqërore. Faktorët e depërtimit të fjalëve me burim oriental tashmë janë të njohur, në radhë të parë dominimi i gjatë ushtarak. Pavarësisht se shqipja tipologjikisht është mjaft e largët me gjuhët altike, megjithatë në krahasim me kohën e gjatë të sundimit ka marrë numër të konsiderueshëm fjalësh.

Për sa i përket rrugës së adaptimit në natyrën e rregullave të shqip foljes, hetohen aspekte të veçanta të këtyre zhvillimeve, si: dukuria e mosekzistimit të zanores /ö/, *örnek-yrnek köfte-qyfte köstek-çystek*, ndryshime shquhen edhe te fonemat *g* në *k*: *gidi-xhidi, gyl-xhyl, kebe-çebe* etj. Tutje alternimi i zanores *u* të rrokjes së hapur të fjalëve të turqishtes së mirëfilltë në zanoren *i*: *avlu-avli,-ja, soylu-sojli,-ja, kutu-kuti,-ja*. Pastaj shënimi i dukurisë së ndërrimit të zanores *y* në *u*, si: *Rrustem, kuvet, kurbet* etj., shndërrimi i zanores *i* në *ë*: *irz-ërz*. Në frazën shqipe prania e elementit oriental nuk del ngjashëm, ngase rendi i përdorimit të ligjëratës së saj, shquan ndikim që kallëzuesi të dalë në fund: */Cidejem eve-Eve gideierum* [shkoj në shtëpi]/.

Po këto pasqyrime me disa ndryshime janë të pranishme edhe në vendbanimin e Mamushës, që deri vonë ishte pjesë e rrethinës së Prizrenit, ndërsa tash është bërë Komunë më vete.

Ndërsa, për sa i përket periudhave të depërtimit të këtyre fjalëve veçohen: periudha e parë: *bori, daulle, mejdan* etj., ndërsa periudha e dytë ajo e shekujve të 17-të e 18-të, kur edhe marrin hov rrethanat e përhapjes së islamizmit edhe në trevat shqiptare: *bajrak, sevap, hoxhë* etj. Pasojë e këtyre është edhe bashkësia e folësve të turqishtes si dhe vetë zhvillimi i këtyre veçorive në këto të folme, e veçanërisht në të folmen e qytetit të Prizrenit si qendra më e rëndësishme jo vetëm e Kosovës.

Fjalë kyçe: dukuri, zhvillim, ndikim, rrethanë, ndërrim etj.

Hyrje

Gjuhësia shqiptare në kuadrin e studimit të dialekteve të shqipes ka arritur rezultate të rëndësishme, është bërë hetimi njohës si dhe përshkrimi i të folmeve gjë që ka dhënë dorë edhe për studim me karakter përgjithësues¹, por mbetet edhe për tu bërë, sidomos për thellimin e shqyrtimit të dukurive në dialekte e në sisteme më të vogla. Sfera e studimit të materialit dialektor në të folmet tashmë të studiuar padysim se nuk mund të ndahet prej kushteve dhe mundësive si dhe nga koha kur janë bërë këto anketime. Diku ka pasur kushte më të mira të studimit e diku edhe kanë mbetur prapa, por ka edhe treva e areale që edhe nuk janë studiuar ose që janë përfshirë në trajtimet përgjithësuese. Për konceptimin e bashkësisë folëse dhe ndërveprimet funksionale të emërtimeve të saj: *fushë folëse* dhe *rrjet folës*, Xhon Gamperci parapëlqente emërtimin *bashkia gjuhësore*, pra nënkuptonte të tri fushat: fushën gjuhësore, fushën folëse dhe rrjetin folës që jo vetëm e shquajnë repertorin e mënyrat e të folurit, por edhe strategjinë e folësit në kuadër të bashkësisë folëse.² Siç edhe është përkufizuar nga gjuhëtarët, kur tashmë nënkuptohet se gjuha është strumbullar i identitetit, nga këndej edhe në zhvillimin e saj, vetvetiu, shquhet nevoja për forma të ndryshme folëse, madje qofshin ato edhe për përmbajtje të caktuara të cilat pësojnë zgjerim a ndërrim të kuptimit sepse marrëdhëniet nuk kanë pasqyruar gjithëherë komunikimin e traditës. Këtë edhe më mirë e identifikon gjeografia gjuhësore e trojeve në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni Veriore, Greqi Veriore, Luginë të Preshevës si dhe tutje në kolonitë arbëreshe jashtë trojeve e në diasporë³. Në thelb të përvijimit ndërveprues, faktorët e kontekstit jashtëgjuhësorë, edhe pse nuk e komunikojnë, ata dëftojnë t'i bëjnë funksionale jo vetëm variantet e caktuara të komunikimit, por edhe mënyrat shprehëse përbrenda raporteve të folësve pjesëmarrës, por gjithashtu, në këtë aspekt të bashkëveprimit qoftë edhe në bashkësi të tjera e mjedise të ndryshme shoqërore.

Në arealet e të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij, ashtu sikurse edhe në të folmet e tjera të arealeve të të folmeve të Kosovës

¹ J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, ETMMK, Prishtinë, 1970.

² D. Hajmz, *Etnografia...*, 1980, f. 94.

³ R. Ismajli, *Gjuhë dhe etni*, "Rilindja", Prishtinë, 1991, f. 43.

dhe më gjerë, ka edhe një numër të vogël të bashkësive gjuhësore që edhe sot në përdorim të tyre gjuhësor e kanë gjuhën e folur turke, pra turqishten. Bashkësi të këtillë gjuhësore⁴ ka në vetë arealin e së folmes së qytetit të Prizrenit⁵ si dhe në rrethinë, gjegjësisht në fshatin Mamushë. Ky vendbanim ka mbi 200 shtëpi si dhe shtrihet në veriperëndim të Prizrenit, rreth 16 km larg këtij qyteti, gjegjësisht në arealin e së folmes së Anadrinit të këtyre të folmeve.

Për sa i përket kësaj bashkësie gjuhësore të turqisht folësve duhet theksuar se nga marrëdhëniet që dalin qoftë në dokumente të shkruara vendore, por edhe në ato të shtetit të Turqisë si dhe në ato të tjera, së paku deri më sot nuk kemi njohuri për ndonjë *dyndje*, *ngulim* apo edhe *shpërngulje* të popullatës orientale e lindore nga trevat e Republikës së Turqisë në këtë anë, përveç okupimit ushtarak të njohur të këtij shteti në tërë territorin e Ballkanit. Prandaj mendojmë se ka të drejtë M. Topalli, i cili në trajtesën studimore: “Substrati i shqipes në turqishten e Prizrenit”, të botuar në revistën e SHLP “Xhevdet Doda”, “Përmbledhje punimesh”, XIII⁶, flet për turqisht folës të cilët në rrethana të caktuara e *pranuan* gjuhën turke, *u deklaruan* si turqisht folës, pra në kushte e rrethana krejtësisht të ndryshme nga ato që duhet të diktojnë të deklarohen.

Kontakti i drejtpërdrejtë i gjuhës shqipe me këtë gjuhën, gjegjësisht kontakti i pandërprerë për disa shekuj me radhë ka bërë që nëpërmjet të kësaj gjuhe si dhe nga ndikimi i saj i fortë⁷ të hyjnë edhe mjaft turqizma në leksikun e këtyre të folmeve të shqipes. Madje, gjithashtu, po nëpërmjet këtij kontakti ndërgjuhësor, në këtë gjuhë kemi edhe një numër fjalësh të tjera që heqin origjinë orientale të ndryshme, qoftë si fjalë perse apo edhe arabizma. Shkaku i lindjes së kësaj ndër ndikese gjuhësore është, apo siç edhe u përkufizua më sipër, në rrethanat të caktuara historike, politike e etnike që u formuan me okupimin osman të këtyre viseve. Ndryshe thënë ata qenë faktorët themelorë të përvetësimit të turqishtes prej një pjese të popullsisë autoktone të këtyre trojeve. Ndikimi apo ndër ndikimi gjuhësorë në këto ambiente të këtyre arealeve M. Topalli mendon se nuk është bërë nga situatat e kontaktit të mirëfilltë ndërgjuhësorë, pra nga interferenca gjuhësore, por nga veprimi *destruktiv* i turqishtes mbi shqipen, apo edhe

⁴ Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, SHLBU, Tiranë, 2003, f. 49.

⁵ N. Hafiz, *Uticaj srpskoghrvatskog i albanskog jezika na turske govore na Kosovu*, “Gjuha dhe praktika-Jezik i praksa”, I, 1979, f. 55.

⁶ M. Topalli, *Substrati i shqipes në turqishten e Prizrenit*, UP, SHLP, “Përmbledhje punimesh”, XIII, f. 33.

⁷ J. Jusuf, *Prizren Türkçesinin Tumce Yapisi*, Cevran, V, 1977, f. 61-68.

më mirë nga dukuria e lënies jo me dëshirë të shqipes prej një numri banorësh si dhe përvetësimit të turqishtes prej tyre⁸. Kjo më tutje edhe dëshmohet me ndryshimet që janë shënuar në fushat e ndikimeve që dëftojnë ligjërimet e këtyre bashkësive gjuhësore nga ligjërimi i gjuhës së mirëfilltë të gjuhës turke e ndonjë tjetër.

Nga ndryshimet në këtë aspekt, që bie më së shumti në pah është dukuria mjaft e përhapur e ekzistimit të zanores /ö/, që ekziston në turqishten e mirëfilltë në vendin amë, Turqi, përkatësisht mosekzistimin e kësaj dukurie të turqisht folësit e këtyre bashkësive gjuhësore, jo vetëm të arealeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij.

Kjo zanore e turqishtes së mirëfilltë, që shënon zanoren qendrore të gjuhës turke, e cila mund të haset në të gjitha pozitat në fjalë, për të cilën bëjnë fjalë edhe shënimet e udhëpërshkruesit turk, Evliya Çelebi (1611-1682), i cili e kishte vizituar pjesën më të madhe të trojeve të Arbërit, Shqipëri, Kosovë etj. Këtë dukuri specialisti i njohur në këtë fushë të këtyre studimeve Robert Dankoff me albanologun e shquar, Robert Elsie (Dankoff-Elsie, 2000, 42-45) e identifikuan në versionin e transliteruar nga turqishtja duke e vërtetuar me faksimile nga tekstet e vjetra. Tutje në këtë aspekt kjo zanore afrohet me ë-në e shqipes, pavarësisht se, siç mendohet mund të ketë qenë më e përparme, por që shkon me interpretimin e ngritjes së lartë, gjegjësisht me zanoren e mirëfilltë të turqishtes: /ö/: *pens-pesë, ishtat-shtatë, Uskup-Shkup, Ipek-Pejë etj.*⁹, pra me në të folmen e turqisht folësve të arealeve të Prizrenit dhe rrethinës së tij, ose edhe më saktë, të folësve më të hershëm të gjuhës shqipe që janë deklaruar turq në këto mjedise. Madje, përveç katër rasteve të përjashtimit, ajo rregullisht është alternuar në *y, ödemek-ydemek, örnek-yrnek, ölmek-ylmek, böbrek-bybrek, börekçi-byrekçi, dösek-dyshek, köfte-qyfte, köpek-çypek, köstek-çystek etj.*, Këtu, megjithatë, shënohen edhe rastet që bëjnë këtë përjashtim si për shembull, me zanoren *e* *dört-dert, dördonnci-derdenxhi, pastaj me zanoren o si psh: göl-xhol, kör-çor, pöstecki-posteçi*¹⁰.

Duke pasur parasysh se kjo dukuri nuk ekziston në të folmen e mirëfilltë të gjuhës turke, atëherë vetvetiu lind pyetja se nga u ndikua kjo pikërisht në këto areale, ndryshe kjo është siç edhe e ka konstatuar me të drejtë M. Topalli rezultat i ndikimit ndër gjuhësor të këtij mjedisi shumë gjuhësor. Gjithashtu në këtë kontekst shquhet po ky ndër ndikim gjuhësor

⁸ M. Topalli, *Po aty*, f. 33.

⁹ R. Ismajli, *Tekste të vjetra*, "Fryma", "Dukagjini", Pejë, 2000, f. 270.

¹⁰ M. Topalli, *Vështrim i cituar*, f. 33.

edhe me gjuhë të tjera në këto mjedise të të folmeve të Prizrenit me rrethinë, këtu po veçojmë ndikimin e gjuhës shqipe në të folmen e malësorëve (goranëve) në një numër fshatrash në pjesën më Jugore të të folmeve verilindore të Kosovës, përkatësisht në njësinë gjeografike të Malësisë së Gorës, si për shembull: *pondryshe* (ndryshe), *kuptujesh* (kupton), *bojdzhaklija* (bojëgjaku), filore (shkolla fillore), gura (gurra), *Gurel cesma* (qeshmja e gurit, Restelicë), *Maj vores*, *Nën aras*, *Maj krei* (Orçikle)¹¹.

Në përimtim të këtij pohimi ai gjithashtu shmang ndikimin e gjuhës sllave ngase edhe sistemi fonetik i të folmeve sllave nuk e ka zanoren *y*. Në këtë aspekt ai si faktor e citon edhe interferencën gjuhësore nga turqisht folësit e mirëfilltë të cilët me rastin e kontaktit të tyre gjatë okupimit, por, për faktor kyç përvijon se folësit e turqishtes së këtyre arealeve më parë, ose para se ta përvetësonin turqishten i kanë takuar ndonjë gjuhë tjetër e cila në sistemin e vet nuk e ka zanoren /*ö*/¹² dhe se këtë e ka zëvendësuar me zanoren *y*. Pra nuk kemi pasur gjuhë tjetër pos gjuhës shqipe, shqipja dhe folësit e saj, e cila në pozitën që kishte, ishte gjuhë e nënshtruar e shtypur si dhe e përbuzur nga një numër banorësh të këtyre arealeve¹³.

Përndryshe, po të ish folur turqishtja prej turqve të mirëfilltë, prej banorëve dhe familjeve të ardhura nga Turqia në Prizren e më gjerë, nuk do të kishte pasur kurrfarë mbështetje gjuhësore, apo edhe ndonjë faktori tjetër jashtëgjuhësorë që me përparësinë e tyre të shtetit okupues të mos e shqiptojnë drejt zanoren e gjuhës së tyre, apo edhe më ndryshe, të theksojnë një zanore që e kanë arealet e të folmeve shqipe të banorëve të kësaj pjese të Gadishullit Ballkanik. Këtë dukuri gjuhësore M. Topalli e shquan si dukuri të substrateve gjuhësore që ka prejardhje prej gjuhës shqipe. Krahës këtij ndryshimi fonetik të sipërpërmendur në gjuhën e turqisht folësve të arealeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij shënohet edhe alternimi i zanores *u* të rrokjes së hapur të fjalëve të turqishtes së mirëfilltë në zanoren *i*: *avlu-avli,-ja*, *soylu-sojli,-ja*, *kutu-kuti,-ja*, *topçu-topçi,-ja*, *pamuklu-pamukli,-ja*, *borçlu-borxhli,-ja*, *sabuncu-sapunxhi,-ja*, *çubuklu-çibukli,-ja*, *orospu-orospi,-ja*, *komsu-komshi,-ja*, *tapu-tapi,-ja*, *davulcu-daullxhi,-ja*¹⁴.

¹¹ S. Idrizi, *Uticaj albanskog jezika na gojor i narodnu poeziju Gore*, FE "Ukshin Hoti", Dega e Gjuhës Boshnjake, f. 3.

¹² M. Topalli, *Vështrim i cituar*, f. 34.

¹³ Gj. Shkurtaj, *Po aty*, f. 174.

¹⁴ M. Topalli, *Substrati i shqipes në turqishten e Prizrenit*, UP, SHLP, "Përmbledhje punimesh", XIII, f. 36.

Përveç arsyeve të sipërpërmendura në alternimin e zanores **u** në **i** në të folmet e këtyre arealeve duhet theksuar edhe mungesën e shkallës së lartë të shqipes në rrokjen e hapur fundore, duke mos mohuar edhe faktin e adaptimit në natyrën e rregullave të shqip foljes. Një dukuri tjetër fonetike e folësve ose përvetësuesve të turqishtes prej elementit të shqiptarëve të këtyre arealeve është edhe shndërrimi i zanores **ũ** të rrokjes së hapur të turqishtes u alternua në **i**, si për shembull: *kũp- ũ-çypi, kũnk, gũ-çyng,-i, gũrũltũ-xhyrylltija, tũrlũ-turli, zũlũfi-zylyfi, sũngũ-syngyi, -ja, mũhũrcũ-myhyrxhi, -ja* etj.

Një karakteristikë e këtyre të folmeve të Prizrenit dhe rrethinës së tij është evidentimi i dukurisë së palatalizimit të zanores ynë **u**, si: *Rustem-Rystem, Muradije-Myradije, kuvet-kyvet, gurbet-gyrbet* etj. Po kështu palatalizimi i zanores **i** në **ẽ** :*irz-ẽrz*, ku në turqishte nuk ka fjalë që fillojnë me **ẽ**, *pastaj i fjalëve:havli-havli, inatçi-inatçi arabaci-arabaxhi, falci-fallxhi, kapi-kapi* etj. Këtë dukuri e hasim edhe te fonemt **g** në **k**: *gidi-xhidi, gyl-xhyl, gevrek-xhevrek, kebe-çebe, Kemal-Cemal*¹⁵, *kitab-çitabetj*. Përveç fushave të tjera në shqipe kanë përdorim edhe një numër prapashtesash që heqin origjinën orijentale. Ndër prapashtesat që më shumë përdoret janë: *-llar, -ler*, etj, si: *agallar, pashallar, hoxhallar, dajallar, ustallar; begler, shehler* etj. Në fund të kapitullit të kreut të katërt të vëllimit “Onomastikë dhe etnolinguistikë”, prof. Shkurtaç flet edhe për një prapashtesë që heq origjinë turke në një numër emrash e mbiemrash në trojet shqiptare dhe po kështu edhe në Kosovë. Fjala është për prapashtesën : *-olli*, nga turqishtja *oglu, ogul* që shquan kuptimin “i biri”, por edhe te disa patronime të burimit shqip e latin si *Durolli, Dreçolli, Demolli*, që ka gjasë të jetë edhe prapashtesë latine *-oll, -ollë, -olle*, për të cilën flet edhe E Çabej, në vëllimin e Studimeve gjuhësore¹⁶. Kjo edhe më behet aktuale ngase siç shton edhe R. Doçi gjurmë të kësaj parashtese gjejmë edhe në onomastikën para turke të Krisobulave të Çabiqit të Llapushës, ku një banorë, më 1330 e kishte emrin *Magol*, mbase nga *mag+oll*¹⁷ etj. Në arealin e këtyre të folmeve ndonëse nuk kemi ndonjë vështrim të përdorimit të kësaj prapashtese reflekse të përdorimeve, si *Demolli, Durolli, Begolli, Bajramolli* si dhe të këtyra reflekse, ka në përdorim të të folmeve të arealeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij.

¹⁵ N. Hafiz, *Uticaj srpskoghrvatskog i albanskog jezika na turske govore na Kosovu*, “Gjuha dhe praktika-Jezik i praksa”, I, 1979, f. 55.

¹⁶ E. Çabej, *Studime gjuhësore*, III, 1976, Prishtinë, f. 262.

¹⁷ F. Papazoglu, *Deçanske hrisevulje*, në “Glas Srp. Učen”. Drusht, u Beogradu, 1980, f. 22.

Megjithatë krahasuar me fjalët e gjuhës turke pohohet se këto orientalizma kanë shtrirje më të pakët në të folmet e këtyre arealeve të të folmeve shqipe. Nga sa ne kemi kuptuar në hulumtimin tonë, kjo fushë, së paku deri më tash, nuk është hulumtuar mjaftueshëm, përveç disa aspekteve përshkruese¹⁸, pra nuk është shqyrtuar në këtë aspekt, në mënyrë të përimituar të hapësira e dialektologjisë e posaçërisht hapësira rurale e trevave të të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij¹⁹.

Gjuha e pasur, e rrjedhshme e autentike e Budit, Bogdanit etj.,²⁰ gjegjësisht e këtyre të folmeve verilindore të Kosovës, pra edhe të folmeve të Prizrenit me rrethinë u përmbys bashkë me gjithë vështirësitë e përballimit të okupimit osman të kohës.

Siç dihet, në fillim, sfera e kontaktit të këtyre ndikimeve ka qenë e fushës fetare, administrative e ushtarake, pra nga ndikimi i domosdoshëm i shtrirjes së okupimit osman në këto troje. Nga këndeje edhe jeta e drejtpërdrejtë me sistemin e dominimit osman si dhe gjuhën e tyre, në periudhë të gjata kohore, kanë bërë që këto elemente orientale të gjejnë shtrirje gati në të gjitha sferat e tjera të jetës në këtë anë. Ky ndikim ka kushtëzuar që një numër i konsiderueshëm fjalësh që janë përdorur në këto kohë të përdoren edhe sot në ligjërimet e këtyre arealeve të së folmes shqipe të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij. Madje një numër fjalësh që ne i përimituam nga subjektet e zgjedhura dialektologjike “mund të thuhet me plot gojë”²¹, se këto fjalë si dhe këto kuptime të këtyre leksemave gjuhësore i kanë përgjegjëset e tyre gjuhësore me origjinë të gurrës shqipe. Një numër i këtyre fjalësh dëgjohen, gati, fare të pa hetuara pranë njëra tjetrës, për të cilat mendojmë se nuk ka nevojë, madje as të dëgjohen as në mënyrë dëftore, si për shembull: *Engjëllushë- Meleqe, Festim –Bajram, Dashurie-Sevdije, Jeton-Jashar, agim-sabah, popull-milet*²², etj.

Në mjedise të caktuara sidomos brendapërbrenda kësaj bashkësie gjuhësore shqipfolësit përdorin një turqishte të pa formë (një *bam bum*, të shformësuar), duke përdorur fjalë shqipe me forma karakteristike të natyrës shqipe në kuadër të ligjërit të gjuhës turke, si për shembull: */Bak sa gûsel!/,* që shquan kuptimin e frazës në këtë gjuhë: *[Bak ne gûzel!-Shiko sa bukur!]*. Gjithashtu po në këtë aspekt në këtë anë shquhet edhe

¹⁸ Gj. Shkurtaj, *Etnografi e të folurit shqip*, Tiranë, 2004, f. 11.

¹⁹ E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, SGJ, Prishtinë, 1986, f. 117.

²⁰ R. Ismajli, *Tekste të vjetra*, “Fryma”, “Dukagjini”, Pejë, 2000, f. 141.

²¹ I. Badallaj, *Po aty*, f. 237.

²² H. Krasniqi, *Antroponimet shqiptare të Prizrenit me rrethinë*, “Onomastika e Kosovës”, IA, Prishtinë, 1978, më 25-27 shkurt 1977, f. 26.

përdorimi i frazës së kësaj bashkësie gjuhësore me natyrë përimituese të shqipes: */Ja sevīm ja ōlūm ben!/,* për shprehjen që përdoret në gjuhën turke: */Ja sev ja ōldū ben!/,* që në gjuhën shqipe ka kuptimin : *[O më duaj, o më vraj!]*²³ */Da isla serçe elde se cūvercin dalda [më mirë zog nëdorë se pëllumb nëdegë]/.*

Ashtu sikurse edhe në të folmet e tjera të të folmeve të Kosovës, edhe në të folmet e Prizrenit autorë kanë evidentuar se në leksikun e të folmeve të shqipes ka një numër të konsiderueshëm orientalizmesh, por gjithashtu në leksikun e kësaj gjuhe hetohet edhe ndikimi i gjuhës shqipe. N. Hafiz²⁴, ndoshta është edhe ndër të parët autorë i cili bën fjalë për ndikimet e gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera mbi turqishten.

Përdorimi i gjuhës shqipe si gjuhë e mjedisit në kontakt në meset ku përdoret edhe gjuha e kësaj bashkësie gjuhësore të turqishtes shquan elemente të natyrës së kësaj gjuhe. Turqisht folësit në këto ambiente dygjuhësore duke mos pasur një formim të rregullt shkollor, si dhe gjithashtu edhe një kulturë jo të kënaqshme të interpretimit gjuhësor, pastaj atë të leximit, madje, në një mënyrë tjetër, duke mos reflektuar as respektin e duhur edhe për gjuhën e bashkësisë tjetër gjuhësore. Në këto mjedise të kësaj hapësire pjesëtarët e kësaj bashkësie gjuhësore kur flasin në gjuhën shqipe janë të prirë që në mjaft segmente, gjë që hetohet si dhe dallohet qartë nga folësit e shqipes që e kanë *gjuhë të zemrës*, mund të thuhet se ata gati përdorin një shqipe të shformësuar duke mënjanuar nga përdorimi, qoftë përsëritjet e kundrinave të drejta e të zhdrejta, qoftë pjesëzat e lidhore, madje edhe nyjat e gjinisë femërore si dhe ato të gjinisë mashkullore.

Në këtë aspekt kanë një përdorim të mirë frazat si *:/Shkova marr !/,* që shquan kuptimin e fjalës pa nyjën të, por që ka frekuencë të dendur përdorimi: */Shkova të marrë bukë/.* Pastaj: */Bleva një këmishë bardha zeza!/,* Që ka kuptimin: */Bleva një këmishë bardhë e zi/, /Ne jemi gzueshme/,* pra që do të thotë se ne jemi të gëzueshëm. Pastaj: */Dy zoga përmī zid!/,* që e ka kuptimin e dy zogjve që janë përmbi mur, pra kemi edhe përzierje të gjuhës edhe të numrit në gjuhën shqipe. */Kjo mīlet është shumë interesant/,* që ka kuptimin se populli është mjaft interesant, gjithsesi se kemi edhe përzierje gjinish, meqë turqishtja nuk e ka këtë kategori. Po i shënojmë këtu edhe disa thënie të tjera: */Insan njeri asht!/, /Dola me dosta në'shehër!/, /Kqyre çfarë syreti/ etj.,* por edhe fraza të tjera

²³ A. Konushevci, *Ligjërimi dhe format e tij*, "Gjuha shqipe", Dukagjini, Pejë, f. 55.

²⁴ N. Hafiz, *Vepër e cituar*, f. 55.

që i ndeshim në arealin e së folmes së bashkësisë gjuhësore të turqishtes në Prizren e Mamushë të Prizrenit. Këto që i theksuam më sipër si dhe një numër të konsiderueshëm fjalësh e shprehjesh të tjera që i gjejmë të përdoren në ligjërimin e shkujdesur në këto areale të së folmes shqipe të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij janë: *bile, demek, hajvan, gazep, javash, kapixhik, çiçek, millet, insan, mashalla, sabahajrollsun, akshamahjrollsun afet, tatli inxhe, abi, efeni, asker, sherr*²⁵, etj..

Aty janë ngulitur që në krye të kohës, gjegjësisht që në kontaktet e dendura të disa shekujve me radhë, të okupimit osman. Ndonëse tendenca e pastrimit të fjalorit nga fjalët e huaja është fryme më e re, megjithatë fjalët me prejardhje orientale edhe sot përdoren në të folmet shqipe. Sfera e ndikimeve gjuhësore në fillim ishte ajo administrativo - ushtarake, por gradualisht ajo përfshiu edhe sferat e tjera si aspektet ekonomike tregtare e sidomos atë fetare. Pjesa dërmuese e popullatës së këtyre mjediseve për t'i ikur atakimeve shtetërore e politike do ta përqafojnë islamizimin si dhe do të lëvizin në bazë rregullave shtetërore në fuqi. Megjithatë, ndonëse nuk ka mjaft fakte bindëse, qëndron edhe mendimi se edhe pjesëtarët e kësaj bashkësie gjuhësore të kenë qenë të për ndjekur, sidomos në kohën e pushtimit sllav. Madje ata shprehen se edhe programet e njohura të Qubrilloviq-Qosiqit²⁶, për formimin e Serbisë së madhe e kanë synuar këtë, sidomos për pastrimin hegjemonist, pra zbrazjen e Kosovës nga jo serbët²⁷.

Megjithatë nuk mund të mos përmendim se edhe nga këto mjedise ka pasur turq "të ndershëm" që kanë shkuar bashkë me elementin shtetëror të pushtuesit, madje, madje edhe të atillë që herë-herë jo vetëm që janë deklaruar pjesëtarë të kësaj bashkësie gjuhësore, por për të qenë më afër këtij regjimi pushtues e kanë ndërruar përkatësinë nacionale, kësajsoj duke u deklaruar edhe pjesëtarë i kësaj bashkësie gjuhësore, duke u deklaruar herë shqiptar e herë duke u konvertuar edhe me përkatësi artificiale të krijesës së ish Jugosllavisë, jugosllav²⁸, pse jo edhe për të mbuluar sistemin "përfaqësues" të politikës shoviniste të kohës.

²⁵ S. Cena, *Vepër e cituar*, f. 333.

²⁶ A. të ndryshëm: *Shpërngulja e shqiptarëve gjatë shekujve*, Prishtinë, 1992, f. 189.

²⁷ Raport i dorëzuar Qeverisë së Republikës së Turqisë-Sylejman Demirelit, më 11.08. 1992, për Dhunën dhe të këqijat që u bëhen joslavëve në Kosovë.

²⁸ B. Ekinçi, *Presionet ndaj turqve dhe dëmin që këtyre ua sjellin disa "intelektualë" turq, bashkëpunëtor të Millosheviqit*, Nr. 19/19, më 18. 05.1991.

Përkrah elementit shqiptar që kryen ritet e besimit mysliman edhe kjo bashkësi gjuhësore i gëzon ritet e jetës e të kultit të këtij besimi. Kjo sferë pikërisht ka lënë gjurmë të thella ngase të gjitha ritet janë kryer në gjuhën orientale. Gjithashtu për sa i përket përdorimit të gjuhës së kësaj bashkësie gjuhësore duhet të theksohet se përdorimi i gjuhës turke në qytetin e Prizrenit si dhe në arealin e së folmes së vendbanimit të Mamushës së Prizrenit, megjithatë nuk shquan një njësi gjuhësore me përhapje shoqërore të ngjashme. Kjo veçanti e përdorimeve jo të ngjashme sidomos hetohet në fushën e përdorimit të të folmeve në sferën e përdorimit morfologjik si: *gel- gjel*, por në këtë aspekt mund të shtojmë se edhe përdorimi i gjuhës shqipe si gjuhë e mjedisit për një kohë të gjatë, ka bërë që këto varietete gjuhësore të kësaj bashkësie gjuhësore të jetë edhe më heterogjene.

Megjithatë nuk kemi ndonjë formacion të veçantë, enklavë apo lagje që shërbehen ekskluzivisht me gjuhën turke, qoftë edhe në vetë fshatin Mamushë të Prizrenit, ku përdorimi i saj është më i dendur, por prapëseprapë nuk mund të paraqet ndonjë specifikë të veçantë të përdorimit të saj gjuhësor. Folësit e këtyre bashkësive gjuhësore mund të kuptohen nga individit folës, gjegjësisht deri në atë masë sa mund të identifikojë edhe vetë bashkësinë gjuhësore përkatëse. Nga sa kemi mëtuar të kuptojmë edhe nga vetë subjektet dialektologjike, gjegjësisht folës të kësaj bashkësie gjuhësore, me gjuhën e kësaj bashkësie gjuhësore është shumë vështirë të komunikohet me gjuhën e sotme standarde turke që sot përdoret në republikën e Turqisë. Për të mos u shprehur në mënyrë edhe më të ndjeshme, madje edhe pjesëtarët e kësaj bashkësie gjuhësore të këtyre arealeve me shumë vështirësi adaptohen në mese të ndryshme të shtetit të Turqisë.

Në kohën e fundit edhe në këtë mjedis banorët e kësaj bashkësie gjuhësore kanë filluar shumë më shumë të integrohen, gjegjësisht të marrin nuse si dhe t'i martojnë bijat e tyre me banorët e vendbanimeve të tjera përreth. Ndonëse jo vetëm në shekullin e fundit, por vazhdimisht pushteti sllav ka manipuluar me këtë bashkësi gjuhësore në kuadër të platformës ekspansioniste ndaj elementit shqiptar duke i aprovuar përparësi të ndryshme.

Në krahasim me bashkësitë e tjera gjuhësore si atë serbe e boshnjake, kjo bashkësi gjuhësore që e përdor gjuhën turke është më e

Ky raport i është dërguar Ambasadës së Republikës së Turqisë në Beograd dhe agjensive informative: “QIK-ut”, “Tanjug-ut” dhe “Vardar-it”.

zbehtë, qoftë për nga përdorimi i gjuhës, qoftë edhe për nga organizimi i vetë bashkësisë. Ndryshe, kjo njësi gjuhësore ka mundësinë përfaqësimit në të gjitha sferat shoqërore e kulturore në këto mjedise të këtyre arealeve të së folmes së qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij. Kësisoj jo vetëm në qytetin e Prizrenit, por edhe në fshatin Mamushë të arealit të së folmes së Anadrinit ka paralele të mësimi fillor e të mesëm që zhvillohet në gjuhën turke. Gjithashtu në këtë aspekt pas Luftës së fundit në Prishtinë si dhe në Prizren funksionon edhe Dega e Orientalistikës në kuadër të Universitetit të Prishtinës. Përkrah këtyre attributeve kjo bashkësi gjuhësore shquhet edhe në aspektin kulturor zhvillon aktivitete të dendura nëpërmjet organizimeve të veçanta, qofshin fetare e kulturore e shoqërore. Në Prizren vepron edhe SHKA, “*Dogry Yol*”, si dhe një numër tjetër seksionesh të tjera të sferave përkatëse. Edhe sfera radio e televizion është e prezantuar në mënyrë të ndjeshme nëpërmjet emisioneve lokale të radiove si dhe të Televizioneve të Kosovës si dhe atyre lokale, ku ka qasje të mirë. Në nivel të Kosovës, në kuadër të RTK-së, ka emisione kulturore periodike si dhe një emisione të përditshme të lajmeve. Në nivel të këtyre arealeve të të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij funksionon Radio Televizioni “*Yeni Dynen*” me një vistër emisionesh në gjuhën e kësaj bashkësie gjuhësore.

Është evidente se kohëve të fundit sidomos brezi i ri e i arsimuar shumë orientalizma po i zëvendëson me fjalë shqipe, madje edhe shumë lutje e përkushtime të riteve fetare po shqipërohen nga gjuha turke në gjuhën shqipe të sotme standarde, madje “në një të ardhme nuk do të dëgjohen më, dhe të tillat do të zëvendësohen plotësisht me fjalë autoktone shqipe”²⁹. Ngase fjalët e huaja të panevojshme, në këtë aspekt, pra jo vetëm këto orientale, por në përgjithësi po ia zënë frymën ligjëritimit të drejtë të gjuhës standarde që është edhe vetë kulturë e gjuhës si dhe ndjenjë të një vendi të qytetëruar do të tërheqë vëmendjen Akademik, Gj. Shkurtaç, në trajtesën që i është qasur kritikës së përdorimit të panevojshëm të fjalëve të huaja në Gjuhën shqipe: “Fjalët e huaja të panevojshme e për fyerjet bombastike po ia zënë frymën shqipes”, të botuar në të përditshmen informative-kulturore të Kosovës “*Zëri*”, në Prishtinë, më 2003 (f. 20). Në këtë aspekt edhe vetë Bashkësia Islame, duke pasur parasysh numrin e besimtarëve, punë të mirë po bën në përkthimin dhe shqipërimin e shumë, teksteve, broshurave si dhe botimin

²⁹ I. Badallaj, *Po aty*, f. 238.

revistave në gjuhën shqipe për integrimin e kësaj kulture fetare, si “Besa”³⁰ etj.

Në vazhdim ne do të veçojmë një numër leksemash me burim oriental që mund të jenë edhe arabizma, fjalë perse por edhe turqizma: *ibret, adalet*³¹, *kadi, a:g, myfti, terexhe, millet, padisha, myderriz, mulla, sade, kafe, pejgamer, saba, içindi, gajtan, konak, adet, amanet, mejdan, xhamadan, gajret, dynja. bylyk, dallash, dever, dollap, dajak, dyzen, gajle, abi, kardash, adash, karabash, pashë, mexhlis, xhami, tyrbe, borxhli, badihava, dert, haber*,³² etj .

Në frazën shqipe prania e elementit oriental gjithashtu del ngjashëm, por edhe e deformuar në rendin e përdorimi të ligjëratës së saj gjë që bën ta dallon edhe këtë turqisht folje nga gjuha zyrtare që flitet në Turqi, ngase kallëzuesi saj del në fund: */Cidejem eve-Eve gideierum* [shkoj ne shtëpi]/.

Në ligjërimin e së folmes së qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij ka një vistër fjalësh që përdoren mjaft dendur, në këtë aspekt kemi veçuar edhe një numër fjalësh të urta janë të ndërtuara nga struktura e këtyre fjalëve që dëgjohen, si për shembull: */Zoti e ka jaratis dynjan!* [Prizren]/, */Dynjaja gjithnji po vjen tue u shtue!* [Korishë]/, */Ku han miku shtohet bereqeti!* [Kabash]/, */Kush ban sabër e gjen selametin!* [Prizren]/, */Haram erdh haram shkoi!* [Atmaxhë]/, */Kurgja s`jet për at dynja, krejt paguhet n`ket dynja!* [Zhur]/.

Përfundime

Gjuha turke, për statusin e së cilës folëm më lart, sot përdoret në disa lagje të qytetit të Prizren si dhe në fshatin Mamushë të arealit të të folmeve të Anadrinit të Prizrenit që në një mënyrë apo tjetër imponon bindjen e pamohueshme për prejardhjen shqiptare të pjesës më të madhe të turqisht folësve të këtyre arealeve. Është me interes të theksohet se shumë banorë të Prizrenit dhe të rrethinës së Prizrenit, që në kohën e ndryshme janë shpërngulur në Prizren, për t’i ikur atakimeve shtetërore të pushtueseve, shpesh janë deklaruar pjesëtarë të pakicës turke si dhe e kanë përdorur gjuhën turke, sidomos kjo është parapëlqyer nga *dyndja e vërrinasve* si dhe *zbritja e opojarëve*, do të shprehet me akribi profesionale e shkencore, profesori, M. Topalli në punimin e cituar më sipër. Më tutje, në këtë

³⁰ “Besa”, Revistë e BI të Prizrenit...

³¹ M. Topalli, *Substrati i shqipes në turqishten e Prizrenit*, UP, SHLP, “Përmbledhje punimesh”, XIII, f. 46.

³² S. Cena, *Disa elemente të gjuhës shqipe në popullsinë e Rahovecit*, GJASSHF, f. 331.

drejtim, mendojmë se janë jo të paktë edhe ata, që me rastin e dyndjeve në Prizren, gjuhën turke e kanë përdorur për t'u veçuar në aspektin "civilizues e atë kulturor". Pavarësisht duke mos i mohuar edhe anën, me dashje e pa dashje elementi shqip ka qenë pre e kësaj kohe, ku padyshim se këtu pos rolit ushtarak e politik ndikim të madh do të luajë edhe feja.

Në fund fare mund të themi se ligjërimi i bashkësisë gjuhësore turke, si dhe asaj boshnjake, gorane e pakicave të tjera shquajnë më shumë pika të takimeve në këto areale të këtyre të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij në krahasim me bashkësitë e tjera gjuhësore e veçanërisht me atë serbe. Natyrisht se kjo çështje hap shtigje meditimit se këto gjuhë u përvetësuan nga elementi vendor për shumë arsye të jetës e të punës, por mbi të gjitha këto duke mos përjashtuar tendencën e përhershme asimiluese të pushtuesve të këtyre trojeve.

BIBLIOGRAFI

- Ajeti, I., *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit...*, GJA, 2, Prishtinë.
- Beci, B., *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre*, "Dituria", Tiranë, 2002.
- Bogdani, P., *Çeta e profetëve*, Padovë, 1685, (Dr. Rudolf Trofenik), Minhen, 1977.
- Badallaj, I., *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001.
- Çabej, E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, SGJ, Prishtinë, 1986.
- Çabej, E., *Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe*, SGJ, V, Prishtinë, 1975.
- Ismajli, R., *Tekste të vjetra*, "Fryma", "Dukagjini", Pejë, 2000.
- Ismajli, R., *Gjuhë dhe etni, Rilindja*, Prishtinë, 1991.
- Jusuf, J., *Prizren Türkçesinin Tumce Yapisi*, Cevran, V, 1977.
- Hysa, M., *Alamiada shqiptare*, "Logos - A", Shkup, 1997.
- Halimi, M., *Kërkime dialektologjike*, Prishtinë, 1985.
- Shkurtaj, Gj., *Etnografi e të folurit shqip*, Tiranë, 2004.
- Shkurtaj, Gj., *Dialektet e shqipes*, Tiranë, 2012.
- Konushevc, A., *Ligjërimi dhe format e tij*, "Gjuha shqipe", Dukagjini, Pejë.
- Mulaku, R., *Gjuha e shkrimeve të vjetra shqipe* (Shek. XV-XVIII), Prishtinë, 2012.
- Lubotenni, G., *Ndryshimet më të qensishme dialektore...*, "Përparimi", X, XI, Prishtinë, 1960.

- Topçiu, V., *Veçoritë fonetike të së folmes së elemntit... të Prizrenit*, Prishtinë, 1988.
- Topalli, M., *Sistemi fonetik i së folmes së qytetit të Prizrenit*, Prishtinë, 1980.
- Topalli, M. *Fjalë e shprehje të rralla të shqipes*, “Jehona”, Shkup, 6/1978.
- Pajaziti, N., *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008.
- Zymberi, A., *Sistemi foljor në të folmen e fshatit Struzhë të Malësisë së Prizrenit*, Prishtinë, 1987.